

**VENDIM**  
**Nr. 262, datë 14.10.2022**

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDROPOWER”  
SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1 germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1799 prot., datë 11.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Hydropower’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydropower” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1747 prot., datë 3.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Hydropower” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, pikës 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, germat “a” dhe “d” dhe pikës 1.3, germa “b”. Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:

*Neni 9, pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **germa “b”**: aplikuesi duhet të përcjellë në ERE me datë të rifrskuar vërtetimin e gjendjes gjyqësore për administratoren e shoqërisë, pasi mban datë më të hershme sesa ajo e parashikuar në nenin 8, pika 3, të rregullores së licencimit. Po ashtu duhet të përcjellë në ERE edhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore për vetë shoqërinë “Hydropower” sh.p.k.

- **germa “c”**: referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të përcjellë informacion nëse ka personel të mjaftueshëm në funksion të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike.

*· Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **germa “a”**: aplikuesi duhet të përcjellë në ERE vërtetimin e detyrimeve tatimore me datë të rifrksuar, pasi mban datë më të hershme se ajo e parashikuar në nenin 8, pika 3, të rregullores së licencimit. Po ashtu duke qenë se konstatohet një detyrim i pashlyer ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, shoqëria duhet të përcjellë edhe vërtetimin për sigurimet shoqërore e shëndetësore me detyrimin të shlyer.

- **germa “c”**: aplikuesi duhet të përcjellë në ERE, Planin e Biznesit për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- *Pika 2.5. Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike.* Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE informacion mbi sasitë e energjisë elektrike (në GWh) të parashikuar për t'u tregtuar gjatë 5 (pesë) vjetëve të ardhshëm.

- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

#### VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Hydrpower” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR  
**Petrit Ahmeti**